



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 35**

**Datë: 27. 12. 2023. Ora: 13:30**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ Nr.33 dhe 34/2023**

**2.Aktivitetet e Zyrës:**

- Rekomandimi për pezullimin e partisë politike LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM;
- Rekomandimi për pezullimin e partisë politike PARTIA SOCIALDEMOKRATE;
- Rekomandimi për shlyerjen e borxheve të partive politike dhe subjekteve politike për periudhën 2014 – 2020 nga Regjistri i llogarive të arkëtueshme

**3.Raportet e Këshillave të KQZ:**

**4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i draft Planit të Punës për vitin 2024

## 4. Të ndryshme

---

### 1. Hyrje: Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

**Kreshnik Radoniqi**, në fillim paraqiti agjendën e mbledhjes potenciale se Gordana Llaban, Arianit Elshani dhe Sami Hamiti mungojnë.

**Alban Krasniqi**, tha se lidhur me pikën 4, si këshill kemi rekomanduar që kjo pikë të shtyhet sepse, ende ka nevojë që “kjo pikë të shqyrtohet” edhe më tutje, të plotësohet etj.

**Sami Kurteshi**, tha se KA ka mbajtur mbledhjen e fundit dhe se, ne duhet të ju informojmë dhe, propozoj që kjo të futet në rend dite.

**Kreshnik Radoniqi**: Me këto propozime, si dhe me pikën si në vijim “Njoftim nga Komiteti i Auditimit”, pyes: Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së me 8 vota për miratuan rendin e ditës, dhe pastaj miratuan procverbalet e mbledhjeve të KQZ: nr. 33 dhe 34/2023.

### 1. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandimi për pezullimin e partisë politike Lëvizja për Bashkëveprim:

**Besnik Buzhala**, drejtor i ZRCKFSP tha se zyra i ka tri rekomandime. E para, ka të bëjë me partinë Lëvizja për Bashkëveprim. Ky subjekt, sipas rregullit ka qenë e obliguar ta mbajë kuvendin zgjedhor të radhës, ka pasur ta mbajë me 8 dhjetor 2023. Mirëpo, ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin. Rekomandojmë pezullimin, dhe ky subjekt pastaj në afat prej 45 ditësh, ta mbajë kuvendin. Nëse edhe gjatë këtij afati nuk e mban kuvendin, atëherë KQZ mund ta c’regjistroj këtë subjekt.

**Alban Krasniqi**, tha se kemi pasur situata të ngjashme ku nuk janë miratuar, aprovuar rekomandimet e zyrës sikur që në nenin 13, pika 10 ku thuhet se subjekti që regjistrohet pas gjashtë muaj duhet ta mbajë kuvendin. KQZ-ja, vepron sipas obligimeve ligjore që ka, dhe në këtë rast, edhe pse “afati 45” nuk është i precizuar në ligj por është pjesë e

rregullores së vjetër. Por kjo rregullore nuk bje ën kundërshtim me ligjin, të njëjtat duhet të jenë obligative për subjektet, por edhe për KQZ-në. Dhe, përmbuashja apo mos përmbushja i ka pasojat e veta.

Dua të them që në situata të këtilla nuk duhet të krijojmë standarde të dyfishta, mos të bëjmë shkelje ligjore prandaj, unë jam i interesuar të kemi standarde të njëjta. Unë, pa marë parasysh subjekti, rrethanat në situatat e këtilla kur na vijnë rekomandime të qarta të bazuara me ligj, të procedojmë ashtu si kërkohet...

Nëse kemi pasur situata që kemi dështuar ta miratojmë rekomandimin e zyrës, pra kemi pasur situatë që se kemi krye detyrën tonë, kërkojë që të formalizohet rekomandimi në mënyrë që ligji dhe rregullat, procedurat të zbatohen me standard të njëjtë...

Në këtë rast, meqë më ka ikur, ju njoftoj se është një dokument që është “draft – pune”, i njëjti do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës dhe, me kërkesën e KOZ-it ne ua dërgojmë që ta keni, ta shqyrtoni dhe ne prap në KOZ, dhe në mbledhjen e radhës ta miratojmë...

**Iir Gashi**, tha se zyra i shterrë mundësitë ligjore dhe po besoj se afatet janë të përcaktuara ën rregullore. Mendoj që ky afat është i shkurtër, dhe meqë jemi në proces të shqyrtimit të rregullave, kjo ish dashur të shihet sepse me duket afat i shkurtër...

Jam për atë, tha z. Gashi që ne ti përmbushim obligimet tona por edhe subjektet politike ti përmbushin detyrimet e tyre sipas ligjit, sipas rregullave të zyrës. Mendoj që duhet të kemi standarde të njëjta, por ka raste kur rrethanat mund të mos jenë të njëjta. Do të doja ta di nëse, janë shterrë të gjitha mundësitë, apo ka arsye që ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin...?

**Bsnik Buzhala** e informoi KQZ-në se subjekti Lëvizja për Bashëkveprim mirëpo, ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin më 8 dhjetor. Por, më 12 dhjetor kjo lëvizja ka kërkuar shtyrje të afatit. Mirëpo, sipas rregullores sonë i bie që afati ka qenë të dërgohet kërkesa së paku dhjetë ditë para mbajtjes së kuvendit, mirëpo “pezullimi” nuk është masë ndëshkuese por mundësi, afat shtesë...

Se a është ky afat në rregull, i mundshëm, i realizueshëm etj., atëherë kjo duhet të diskutohet...

Në këtë pikë, diskutoi Alban Krasniqi i cili konstatoi se subjektet vetëm duhet ti zbatojnë rregullat, ligjin çështjet tjera të demokracisë e brendshme partiake, justifikimet, arsyet etj.,

ato janë pjesë që ne nuk duhet të futemi aty por ti kryjmë detyrimet tona me rregulla dhe me ligj. Duhet të jemi vetëm ën mbështetje të ligjit, rregulloreve tona që nuk bien ndesh me ligjin. Po ashtu, diskutoi edhe Ilir Gashi.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ –së me 8 vota për miratuan pezullimin e partisë politike Lëvizja për Bashkëveprim. Mirëpo, e njëjta ka afat prej 45 ditësh për mbajtjen e kuvendit.

Rekomandimi për pezullimin e partisë politike Partia Socialdemokrate:

**Besnik Buzhala** tha se zyra, për të njëjtat arsye edhe ky subjekt rekomandohet që të pezullohet. Zyra, ka vepruar sipas detyrimeve që ka.

**Ibrahim Selmanaj**, tha se kur subjekti nuk i kryen detyrimet, atëherë ne duhet të procedojmë dhe të ecim përpara. **Sami Kurteshi**, tha se po vërehet njëfarë mos discipline e subjekteve, pra ligjvënësi dhe KQZ-ja kanë qenë mjaft gjeneroze mirëpo, KQZ ka të drejtë tolerimi vetëm brenda afatit ligjor, por pastaj merr vendim...Duhet të marrë vendim, mirëpo para nja dy javësh nuk e kemi marrë një vendim që, ishim të obliguar ta merrnim, gjë që a po bëjmë shkelje ligjore...

Në situatë të ngjajshme, subjektet trajtohen në mënyrë të ndryshme...! Pra unë e kamë një dilemë: cka do të bëjmë më atë që se kemi marrë vendimin në rastin e kaluar...?

Në vazhdim, anëtarët e KQZ –së me 8 vota për miratuan pezullimin e Partisë Social Demokrate e cila, ka afat prej 45 ditësh për mbajtjen e kuvendit.

Rekomandimi për shlyerjen e borxheve të partive politike dhe subjekteve politike për periudhën 2014 – 2020 nga Regjistri i llogarive të arkëtueshme:

**Besnik Buzhala** tha se zyra, e ka edhe këtë rekomandim: shlyerjen e borxheve të partive politike dhe subjekteve politike për periudhën 2014 – 2020 nga Regjistri i llogarive të arkëtueshme.

Z. Buzhala, shpjegoi se si ka ardhë deri te dënimi i subjekteve, deri te shlyrja e borgjeve, si janë procedurat, cilët hapa i ka ndjekur KQZ etj. Ne, zyra, ka përgatitur një raport në këtë aspekt...

( Post scriptum: mbledhja, nuk është e regjistruar më tej...)